

Komuna e Prishtinës
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Sektori i Kulturës shpall këtë

NJOFTIM

për subvencionimin e Arteve Vizuale, Ekspozitave, Manifestimeve dhe Organizimeve kulturore në Kryeqytet për vitin 2016

Të drejtë për aplikim kanë të gjitha Institucionet e pavarura kulturore të kryeqytetit, OJQ-të, bizneset, kompanitë dhe individë me projekt propozime për organizimin e ekspozitave dhe manifestimeve kulturore në kryeqytet për vitin kalendarik 2016.

Për të aplikuar për përkrahje financiare nga fondi për subvencione aplikuesit duhet të dorëzojnë projekt propozimin me informacione si në vijim:

për artist individual

- përshkrimi i detajuar i projektit;
- qëllimet e projektit dhe rezultatet e pritura;
- periudha e realizimit të projektit;
- biografia e shkurtër e personave kyç të përfshirë në projekt;
- buxheti total i projektit;
- buxheti i kërkuar nga Komuna;
- emri dhe mbiemri i aplikuesit;
- numri i telefonit dhe email adresa e aplikuesit;
- kopja e letërnjoftimit të aplikuesit;
- vërtetimin nga banka për llogarinë bankare personale të aplikuesit.

për OJQ dhe Biznese

- përshkrimi i detajuar i projektit;
- qëllimet e projektit dhe rezultatet e pritura;
- periudha e realizimit të projektit,
- biografia e shkurtër e personave kyç të përfshirë në projekt
- buxheti total i projektit;
- buxheti i kërkuar nga Komuna;
- emërtimi i OJQ-së/ biznesit;
- kontakti i personit përgjegjës – numri i telefonit dhe e mail adresa;
- kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar,
- kopja e fletëregjistrimit të OJQ-së/ biznesit,
- kopja e certifikatës së numrit fiskal të OJQ-së/ biznesit,
- vërtetimin nga banka për llogarinë bankare të OJQ-së/ biznesit.

Projekt propozimet mund t'i dorëzoni deri më **01/06/2016**, në orën **15:00** në adresën: **Komuna e Prishtinës (ndërtesa e vjetër), Zyra pritëse, Sporteli nr.5.**

VËREJTE: Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës dhe aplikuesit të cilët nuk kanë përmbyllur projektin nga edicioni i kaluar ndaj DKRS - së, nuk do të merren parasysh nga komisioni për shqyrtimin e kërkesave.